

# Ruhuni nga librat e autorit Halid Muhamed Halid, sidomos libri i tij "Burrat përreth Pejgamberit" i përkthyer edhe në gjuhën shqipe

## Paralajmërimi i dijetarëve të ummetit për disa nga librat e autorit Halid Muhamed Halid

1) Muhamed bin Ibrahim Alu Shejkh, ish Muftiu i Arabisë Saudite – *Allahu e mëshiroftë* – ka thënë për disa nga librat e tij:

“...për sa i përket prezencës së disa librave që përmbajnë *ilhad* (kufër dhe lajthitje), të cilat synojnë që të përhapin parimet shkatërrimtare, siç është libri “*Min huna nebde*” (i autorit Halid Muhamed Halid)”, po ju njoftojmë se këto libra janë të dëmshme për akiden dhe fenë. Është obligim që të njoftohet dogana dhe inspektorët e botimeve, që të mos i lëshojnë librat e këtillë dhe të mos lejojnë që të futen në Mbretëri (të Arabisë Saudite). Po ashtu, edhe libri i ri i Halid Muhamed Halid, “*Hadha eu et-tufan*”, duhet të ndalohet dhe duhet të bëjnë kujdes që mos ta fusin brenda në shtet, sepse këto libra janë të padobishëm dhe janë të dëmshëm. Me këto libra synohet që të thirren njerëzit në *riddeh* (lëshim të fesë Islame), *ilhad* (kufër dhe lajthitje) dhe degjenerim. Allahu na ruajttë nga fitnet që të devijojnë.”<sup>1</sup>

2) Shejkh bin Bazi – *Allahu e mëshiroftë* – është pyetur për autorin e librit “Burrat përreth Pejgamberit”

**Pyetje:** Shkëlqesia juaj, çfarë mendimi keni për librat e Halid Muhamed Halid, veçanërisht për librin “Burrat përreth Pejgamberit” – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – dhe librin “Khalifët e të Dërguarit” – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –?

---

<sup>1</sup> Burimi: Mexhmu’u Fetaua ue Rasail, 13/146.

**Përgjigje:** “Unë nuk i kam lexuar këto libra. Kurse autorin e njohim që ka libra të vjetër që nuk janë të mirë. Një prej këtyre librave është libri “*Min huna nebde*” ose një titull të përafërt me këtë. Ky libër nuk është i mirë dhe kundër këtij libri janë shkruar refuzime. Nëse ky libër (Burrat përreth Pejgamberit) është shkruar mbrapa këtij (Khalifët e të Dërguarit), atëherë nuk di gjë, sepse nuk i kam lexuar librat e tij të fundit e as librin që u përmend në fillim.”<sup>2</sup>

3) **Shejkh Mukbil ibn Hadi el-Uadi'i** – *Allahu e mëshiroftë* – është pyetur për librin “**Burrat përreth Pejgamberit**”.

**Pyetje:** Cili është mendimi juaj për librin “Burrat përreth Pejgamberit,” të Halid Muhamed Halid?

**Përgjigje:** “Po ashtu, ky autor nuk është i besueshëm në fe, ky njeri nuk është i besueshëm në fe e as që posedon dije për njohjen (e haditheve) autentike dhe të dobëta. Për më tepër, ai saktëson atë që ia ka qejfi dhe dobëson atë që nuk ia ka qejfi.”<sup>3</sup>

—

---

<sup>2</sup> Burimi: <https://binbaz.org.sa/old/34620>

<sup>3</sup> Burimi: [http://www.muqbel.net/fatwa.php?fatwa\\_id=1476](http://www.muqbel.net/fatwa.php?fatwa_id=1476)

## [Shënim i përkthyesit]

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit. Të gjitha lavdet i takojnë Allahut, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë për të Dërguarin e Allahut, familjen e tij, shokët e tij si dhe për të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij me përpikëri deri në Ditën e Gjykimit.

Më tej:

Në vazhden e refuzimeve të dijetarëve, do të sjellim një sërë sharjesh dhe shpifjesh ndaj Sahabëve që gjenden në librin **“Burrat përreth Pejgamberit”** të autorit Halid Muhamed Halid. Ky libër është botuar nga shtëpia botuese “Orienti” në vitin 2008, i përkthyer nga boshnjakishtja në shqip. Po ashtu, ky libër promovohet dhe shitet nga shtëpia botuese “NUN” e **Bekir Halimit**, një ndër kokat e Ikhuatul-Musliminëve (sektit Vëllazëria Muslimane) në trojet shqiptare. Libraria e NUN-it është këshilluar në vitin 2016 në faqen e saj në Facebook që ky libër përmban sharje dhe shpifje për Muauijen – radijAllahu anhu – por ata e kanë fshirë komentin në Facebook dhe e kanë fshirë postimin për këtë libër. (Shiko fotot më poshtë).

### Postimi i NUN-it në vitin 2016

13 people have been here

Open - 09:00 - 17:00  
Get additional info

Invite friends to like this Page

4.8 of 5 stars · 30 reviews  
View reviews

ABOUT

rr.Petre Georgiev nr.6 . përball ambullan...  
Save Skopje

+389 2 323 0827

Open  
Today 09:00 - 17:00

**NuN**  
Yesterday at 12:52 · 🌐

Halid Muhammed Halid  
Burrat përreth pejgamberit - paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi te  
Lokacioni - Përball Ambullantës Bit Pazarit  
Shtëpia botuese "NuN

Create Page

Recent

2016

2015

2014

## Komenti poshtë këtij postimi

Today 09:00 - 17:00

Ask for NuN's price range

Typically replies within an hour

[Message Now](#)

<http://www.nun.com.mk/>

PHOTOS



Like Comment Share

56 Top comments ▾

1 share

Write a comment...

ky liber eshte harram te shi tet, sepse nxit urrejtje kunder Muauijes radijAllahu anhu, Une e kam lexuar te terin qe moti dhe me vone ka kuptuar se ky liber nxit urrejtje per muaijen. kini frike Allahun e mos e shitni se keni pergjegjesi para Allahut ditën e gjykimit. Cdo njeri qe e njuh se cfare akideje keni ne per sahabet dhe cfare respekti te madh duhet te kemi ne ndaj tyre, e kupton se ky liber shaban sahabet, pra ata qe ishin me Muaijen, kurse ulemat kane shpjeguar se ne nuk duhet te futem ne mes asaj qe kan ndodh ne mes sahabeve. sepse cdo njeri nga ata ka qene muxhtehid dhe sahabet nuk permenden vetem se per hajr, ndersa ajo qe ka ndodh ne mes tyre nga fitnet dhe trazirat, nuk permendet fare. seps e kjo na con tek akideja e rafidijve.

Like · Reply · Just now

**Dituria El-Marife** Sa esht cmimi  
Like · Reply · 19 hrs

**NuN** 700 den 11.5 euro  
Like · Reply

2015  
2014

## Bllokimi i komentuesit

Today 09:00 - 17:00

Ask for NuN's price range

Typically replies within an hour

[Message Now](#)

<http://www.nun.com.mk/>

PHOTOS



Like Comment Share

56 Top comments ▾

1 share

Write a comment...

ky liber eshte harram te shi tet, sepse nxit urrejtje kunder Muauijes radijAllahu anhu, Une e kam lexuar te terin qe moti dhe me vone kam kuptuar se ky liber nxit urrejtje per muaijen. kini frike Allahun e mos e shitni se keni pergjegjesi para Allahut ditën e gjykimit. Cdo njeri qe e njuh se cfare akideje duhet te kemi per sahabet dhe cfare respekti te madh duhet te kemi ne ndaj tyre, e kupton se ky liber shaban sahabet, pra ata qe ishin me Muaijen, kurse ulemat kane shpjeguar se ne nuk duhet te futemi ne mes asaj qe kane ndodh ne mes sahabeve. sepse cdo njeri nga ata ka qene muxhtehid dhe sahabet nuk permenden vetem se per hajr, ndersa ajo qe ka ndodh ne mes tyre nga fitnet dhe trazirat, nuk permendet fare. seps e kjo na con tek akideja e rafidijve.

Like · Reply · ⚠ Unable to post comment. Try again · Edited

**Dituria El-Marife** Sa esht cmimi  
Like · Reply · 19 hrs

**NuN** 700 den 11.5 euro  
Like · Reply · 1 · 3 hrs


Create Page

Recent

2016  
2015  
2014



## Eshirja e postimit



Mbas kësaj këshille, në vitin 2019, NUN-i përsëri e shet këtë libër që shan e shpif kundër Sahabëve. (Shiko foton në vijim)



## Sharjet dhe shpifjet ndaj Muauijes

- radijAllahu ‘anhu -

Sa herë që Mu’uajja – Allahu qoftë i kënaqur me të – përmendet në këtë libër “**Burrat përreth Pejgamberit**”, autori asnjëherë nuk thotë për të “*radijaAllahu anhu - Allahu qoftë i kënaqur me të!*”. E sikur të mos mjaftonte kjo, autori:

1. ka shpifur ndaj Mu’auijes – Allahu qoftë i kënaqur me të – kinse ai e ka kërcënuar me vrasje Abdullah ibën Umerin – Allahu qoftë i kënaqur me të – ku thotë: “**Mirëpo, edhe pse ishte neutral dhe qëndronte anash, ai kurrë nuk ka qenë dyfytresh. Shumë herë e ka kundërshtuar Muaviun me provokime të dhimbshme dhe hetuese, derisa ai e kërcënoi se do ta vriste.**” [fq. 87]

2. ka shpifur ndaj Mu’auijes – Allahu qoftë i kënaqur me të – kinse ai luftoi kundër Aliut – Allahu qoftë i kënaqur me të – për pozitë dhe kalifat: “**Përsikaj kësaj, siç duket Othmani – radijAllahu anhu – nuk i kushtoi vëmendje të mjaftueshme, brengosje dhe reagim të duhur siç e meritonte ky problem. Kështu që ndodhi rasti në të cilin u vra Othmani – radijAllahu ‘anhu – ndërsa dyert e rebelimit kundër muslimanëve u hapën me të madhe. Muaviu e filloi luftën kundër kalifit të ri, pra Aliut – radijAllahu anhu – duke luftuar për pozitën e sunduesit dhe për kalifat.**” [fq. 171]

3. shan Mu’auijen – Allahu qoftë i kënaqur me të – duke thënë se ai është njeri i dashuruar mbas kësaj bote dhe njeri i uritur për pushtet: “**Pastaj kthehej dhe e shikonte Palestinën ku sundonte njeriu i dashuruar mbas kësaj botë dhe njeriu i uritur për pushtet, Muavie ibën Ebi Sufjani.**” [fq. 179]

4. shan dhe shpif ndaj Mu’auijes – Allahu qoftë i kënaqur me të – se ai e konsideronte Egjiptin si margaritarin më të vlefshëm të mbretërisë të Tij dhe se ai nuk donte që Kajsi të jetë prijës në Egjipt: “**Muaviu gjithmonë kishte pretendime mbi Egjiptin, sepse e konsideronte si margaritar të tij të prosperuar. Për këtë shkak, Muaviu sapo dëgjoi se Kajsi duhet të jetë mëkëmbës në Egjipt, e humbi vetëkontrollin dhe u tmerrua nga kjo. Se Kajsi përherë do t’i dalë në rrugë për ta sunduar Egjiptin, madje edhe nëse korrë fitore të sigurt ndaj Aliut – radijAllahu ‘anhu. Kjo ishte arsyeja që i përdori të gjitha metodat e mashtrimit**

dhe truket e paskrupullta me qëllim që Kajsin ta shpif te Aliu – radijAllahu ‘anhu. Në fund Aliu – radijAllahu ‘anhu – e urdhëroi që ta lëshojë Egjiptin. Kajs kishte të drejtë legjitime që ta shfrytëzonte dinakërinë e tij. Ai e kishte kuptuar se me siguri Muaviu pasi që i kishte shkuar për dore që ta përfitojë në anën e tij, e kishte nxitur Aliun – radijAllahu anhu – kundër tij, pra me ndihmën e mashtrimeve të tij dhelparake. Qëllimi i tij ishte që ta nxiste Aliun – radijAllahu ‘anhu - kundër Kajsit, duke zgjuar dyshimet në besnikërinë e tij. Për këtë shkak, përgjigja më e mirë ndaj trukeve qëllimkëqija të Muaviut ishte që të tregojë besnikëri më të madhe ndaj Aliut – radijAllahu ‘anhu – dhe asaj që ishte ai.” [fq. 248]

## Disa shpifje dhe fyerje kundër Sahabëve të tjerë në përgjithësi

1. ka shpifur kundër **Talha ibën Ubejdullah** – Allahu qoftë i kënaqur me të – kinse ai i përkrahte argumentet e kundërshtarëve të Uthmanit – radijAllahu ‘anhu – (pra argumentet e Khauarxihëve kundër Othmanit): “Gjatë kohës së kalifatit të Othmanit – radijAllahu ‘anhu – u paraqit konflikti (që tanimë është mirë i njohur). Talha i përkrahte argumentet e kundërshtarëve të Ohtmanit dhe qëndronte në anën e tyre në shumë kërkesa për ndryshime dhe reforma.” [fq. 279-280]

2. ka shpifur kundër **Abdur-Rrahman ibën Ebu Bekër** – Allahu qoftë i kënaqur me të – kinse ai e konsideronte Mu’auijen rrezik për Islamin: “Abdurrahmani shumë mirë e dinte se çfarë rreziku i kërcënohet Islamit nëse Muaviu arrin qëllimin e tij.” [fq. 415]

3. ka sharë sahabiun **Ebu Dherr el-Gifarij** – radijAllahu ‘anhu – duke e paraqitur atë si njeri që akuzon Ebu Musa el-Esharijun dhe Ebu Hurejren si njerëz të dhënë pas pasurisë së dunjasë dhe pushtetit: “Ebu Dherri shkoi aq larg sa që distancohej prej vëllezërve të tij që nuk largoheshin prej këtyre gjërave. Arsyeja e vetme ishte se u bënë sundues dhe se tani janë bërë njerëz të pasur. Njëherë e kishte takuar Ebu Musa el-Eshariu – radijAllahu anhu. Nga gëzimi që e kishte pa, i shtriu duart, e i tha: “Mirë se erdhe, o Ebu Dherr! Mirë se erdhe vëllai im!” Mirëpo, Ebu Dherri u tërhoq, duke thënë: “Nuk jam vëllai yt! Isha vëllai ut derisa nuk u bëre administrues dhe mëkëmbës.” Ngjashëm e kishte takuar edhe Ebu Hurejran – radijAllahu anhu – i cili e kishte përqaftuar duke i dëshiruar mirëseardhje. Mirëpo, Ebu

Dherri e shtyu duke i thënë: “Vallë, nuk je ai që u bërë mëkëmbës, e tani i zgjerove ndërtesat, lëndinat dhe pallatin?” Ebu Hurejre - radijAllahu ‘anhu - u përpoq që të mbrohet duke u treguar se është i pafajshëm. Por, edhe duke i demantuar zërat që vinin në adresë të tij.” [fq. 59]

4. ka shpifur kundër **Ebu Musa el-Esharijut** - Allahu qoftë i kënaqur me të - kinse ai thotë se Amër ibën Asi - Allahu qoftë i kënaqur me të - ka thënë që kalifati jepet në bazë të aristokracisë: “Ebu Musa: “Ke frikë Allahun, o Amër. Sa i përket asaj që e the lidhur me aristokracinë e Muaviut, se kalifati jepet në bazë të aristokracisë, atëherë më së shumti të drejta prej të gjithë njerëzve për të do të kishte Ebreha ibën Sabahu.” [fq. 469]

5. ka shpifur kundër **Abdullah ibën Abbasit** - Allahu qoftë i kënaqur me të - kinse ai ia kishte tërhequr vërejtjen Ebu Musa el-Esharijut për mashtrimet e Amër ibën Asit: “**Ibën Abasi** ia kishte tërhequr vërejtjen atij kur ishte kthyer dhe e kishte lajmëruar për dredhirat e Amrit duke i thënë: “Pasha Allahun, kam frikë se Amri do të mashtrojë. Kështu që nëse ju të dy jeni marrë vesh për diçka, atëherë le të dalë ai i pari e të thotë se çfarë ka, e pastaj ti pas tij.” [fq. 470]

---



## Qëndrimi i Ehli Sunetit për grindjet dhe mospajtimet që ndodhën ndërmjet Sahabëve - *radijAllahu 'anhum* -

Allahu i Madhëruar ka thënë:

وَالسَّابِقُونَ الْأَوْلَىٰ مِنْ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ وَأَعَدَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٠٠﴾

“Sa u përket pararendësve (në besim), të parëve nga Muhaxhirët (emigruesit nga Mekka për në Medine) dhe Ensarët (vendasit në Medine që i mirëpritën dhe i strehuan Muhaxhirët) dhe atyre që i pasuan me përpikmëri, Allahu është i Kënaqur me ta, po ashtu edhe ata janë të kënaqur me Atë...”<sup>4</sup>

Ibën Kethiri – Allahu e mëshiroftë – në komentimin e këtij ajeti, thotë:

“Allahu i Madhëruar ka njoftuar se ai është i Kënaqur me pararendësit, të parët e Muhaxhirëve dhe Ensarëve si dhe me cilindo që i pason ata me përpikmëri. Por ama mjerë për atë që i urren ata, ose i shan ata, ose i urren disa prej tyre apo i shan disa prej tyre.”<sup>5</sup>

Allahu i Lartësuar ka thënë për Muhaxhirët:

لِلْفُقَرَاءِ الْمُهَاجِرِينَ الَّذِينَ أُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ وَأَمْوَالِهِمْ يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِنَ اللَّهِ وَرِضْوَانًا وَيَنْصُرُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ أُولَٰئِكَ هُمُ الصَّادِقُونَ ﴿١٠١﴾

“(Në këtë plaçkë lufte) ka hise edhe për fukarenjtë e Muhaxhirëve, të cilët u dëbuan nga shtëpitë dhe pasuritë e tyre; (që e emigruan) duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e

<sup>4</sup> et-Teubeh, 100.

<sup>5</sup> Tefsir Ibën Kethir, 4/203.

Allahut, dhe që ndihmojnë Allahun (fenë e tij) dhe të Dërguarin e Tij, të tillët janë ata të singertit (në fjalë dhe vepra).<sup>6</sup>

Allahu i Lartësuar ka thënë për Ensarët:

وَالَّذِينَ تَبَوَّءُوا الدَّارَ وَالْإِيْمَانَ مِنْ قَبْلِهِمْ يُحِبُّونَ مَنْ هَاجَرَ إِلَيْهِمْ وَلَا يَجِدُونَ فِي صُدُورِهِمْ حَاجَةً مِمَّا أُوتُوا  
وَيُؤْتِرُونَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ خَصَاصَةٌ

“Edhe ata që kishin shtëpi (në Medine) dhe e kishin pranuar fenë (Islame) para tyre (Muhaxhirëve), i duan ata (Muhaxhirët) që u shpërngulën tek ata (Ensarët) dhe nuk ndejnë xhelozitë në gjokset e tyre nga ajo që u jepej atyre (Muhaxhirëve), madje ata (Ensarët) u jepnin përparësi atyre para vetvetes edhe pse ata vet ishin nevojtarë...”<sup>7</sup>

Shejhul Islam Ibën Tejmijeh – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Nga bazat e Ehli Sunnetit dhe Xhematit është: se ata i kanë të pastra zemrat dhe gjuhët e tyre karshi Sahabëve të Pejgamberit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, ashtu siç i ka përshkruar Allahu në Fjalën e Tij:

وَالَّذِينَ جَاءُوا مِنْ بَعْدِهِمْ يَقُولُونَ رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيْمَانِ وَلَا تَجْعَلْ  
فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ ءَامَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ

“Edhe ata që kanë ardhur pas tyre (Sahabëve) thonë: "Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që na kanë paraprirë në besim dhe mos lejo në zemrat tona asfarë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë, me të vërtetë që Ti je i Butë e Mëshirëplotë.” El-Hasher, 10

Po ashtu i bindemi të Dërguarit të Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – kur ai thotë:

لَا تَسُبُّوا أَصْحَابِي لِأَنْتُمْ سَبُّوا بِئْسَ مَا أُدْرِكُ مُدًّا  
أَحَدِهِمْ وَلَا نَصِيفَهُ.

<sup>6</sup> El-Hashër, 8.

<sup>7</sup> el-Hashër, 9.

*“Mos i shani Sahabët e mi! Mos i shani Sahabët e mi! Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, nëse ndonjëri nga ju do të shpenzonte flori aq sa kodra e Uhudit, ai nuk arrin dot me të asasinë e dy grushtave bashkë që kanë dhënë ata, e madje as gjysmën e asaj sasië.”<sup>8</sup>*

Ata i pranojnë vlerat dhe pozitat që kanë Sahabët, të cilat janë përmendur në Kur'an, në Sunnet dhe në Ixhma. Ata nuk besojnë që Sahabët janë të pagabueshëm dhe që nuk bien në mëkate të mëdha e të vogla, por ata, në përgjithësi, bien në mëkate. Mirëpo ata kanë dhënë mund dhe kanë vlera, të cilat ua shlyejnë mëkatet e tyre, nëse bëjnë mëkate. Madje, atyre u falen vepra t e këqija, të cilat nuk u falen atyre që erdhën mbas Sahabëve, për arsye se Sahabët kanë vepra të mira që i fshijnë të këqijat, kurse ata që erdhën pas tyre nuk i kanë ato vepra të mira.

Pastaj, nëse ndonjëri prej tyre ka bërë një mëkat dhe është penduar, ose ka bërë vepra të mira që e fshijnë atë mëkat, ose ai mëkat i është falur për shkak të meritave që ai i ka patur përpara se të bie në këtë mëkat, ose për shkak të ndërmjetësimit të Muhamedit – sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem –, pasi Sahabët janë njerëzit më meritorë për ndërmjetësimin e tij, ose është sprovuar në dunja me ndonjë fatkeqësi dhe ai mëkat i është falur. Përderisa çështja është kështu për mëkatet e qarta, atëherë si është çështja për gjërat në të cilat ata bënë ixhtihad; nëse ia kanë qëlluar, kanë dy shpërblime, e nëse kanë gabuar, kanë një shpërblim, ndërsa gabimi i tyre është i falur?

Pastaj, ato vepra që u refuzohen atyre, të cilat janë të pakta dhe të papërfillshme, veniten përpara meritave dhe mirësive që kanë ata, siç është besimi në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, xhihadit në rrugë të Tij, hixhreti, ofrimi e ndihmës, dituria e dobishme dhe punët e mira.

Kush e shikon me vëmendje jetëshkrimin e Sahabëve, duke patur dituri dhe me mendje të hapur, si dhe shikon meritat që Allahu ua ka dhënë atyre, do të mësojë me bindje të thellë që ata janë njerëzit më të mirë pas Pejgamberëve, nuk pa patur dhe nuk do të ketë njerëz të ngjashëm me Sahabët; se ata janë elita e brezave të këtij ummeti, i cili është më i mirë dhe më fisniku tek Allahu i Lartësuar sesa të gjitha umetet e tjera.”<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> E ka transmetuar Muslimi (n.2540).

<sup>9</sup> Mexhmu’ul-Fetaua, 3/152-156, (përkthim i përmbledhur).

**Hafidh Ibën Haxheri** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Ehli Sunneti kanë unanimitet për obligueshmërinë e ndalimit të sharjes së ndonjërit prej Sahabëve, për shkak të konflikteve që kanë ndodhur ndërmejt tyre, edhe në qoftë se dihet se kush nga ata ka pasur të drejtë. Sepse ata nuk morën pjesë në ato luftëra përveç se me ixhtihadin e tyre, e Allahu e ka falur atë që ka gabuar në ixhtihadin e tij. Madje, është vërtetuar (në hadith) se ai (që gabo) ka një shpërblim, kurse ai që ia ka qëlluar ka dy shpërblime.”<sup>10</sup>

**Abdullah ibën Umeri** – Allahu qoftë i kënaqur me ta – ka thënë:

“Mos i shani shokët (Sahabët) e Muhamedit, sepse qëndrimi i tyre (me Pejgamberin – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për një çast, është më i mirë sesa adhurimi që bën ndonjëri prej jush për dyzetë vjet.”<sup>11</sup>

**Imam Ahmedi** – Allahu e mëshiroftë – është pyetur:

“Çfarë thua për atë që pretendon se lejohet të flitet për gabimet e Sahabëve të të Dërguarit të Allahut – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem -?” Ai tha: “Këto janë fjalë të këqija e të ulta! Duhet të bojkotohen ata njerëz (që e thonë atë fjalë), nuk duhet të ulesh me ta dhe çështja e tyre duhet t’u sqarohet njerëzve.”<sup>12</sup>

**Ebu Zur’ah err-Rrazij** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Nëse shikon dikë që flet keq për ndonjë nga Sahabët e të Dërguarit të Allahut – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, atëherë dije se ai është zindik. Kjo çështje është kështu sepse i Dërguari – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – për ne është i vërtetë dhe Kurani është i vërtetë. Kuranin dhe Sunnetin nuk na i përcollën përveçse Sahabët e të Dërguarit të Allahut – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem. E ata duan veçse që t’i kritikojnë dëshmitarët tanë (Sahabët) me qëllim që ta bëjnë të pavlerë Kur’anin dhe Sunnetin. E në realitet ata janë që meritojnë të kritikohen, e ata janë zindikë.”<sup>13</sup>

**Dhehebiu** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

---

<sup>10</sup> Fet’hul-Barij, 13/34.

<sup>11</sup> Fadailu es-Sahabeh, i Imam Ahmedit, 1729.

<sup>12</sup> “es-Sunneh” i Khal-lal-it, 825.

<sup>13</sup> el-Kifajeh fi ‘Ilmi er-Riuajeh,” fq. 49.

“Gjithashtu, është vërtetuar tashmë që s’duhet të futesh assesi në grindjet dhe ndërluftimet që ndodhën midis Sahabëve – Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata – dhe ne vazhdimisht shohim vepra, libra dhe fletushka që përmendin ato gjëra, mirëpo shumica e atyre janë transmetuar me zinxhirë të shkëputur, të dobët dhe disa prej tyre madje janë gënjeshtër.”<sup>14</sup>

**Jahja Ibën Me’ini** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“...kushdo që e shan Uthmanin ose Talhan ose ndonjërin nga Sahabët e Pejgamberit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – është dexhall, atij nuk i merret hadithi. Mallkimi i Allahut, i melaikeve dhe i gjithë njerëzve qoftë mbi të.”<sup>15</sup>

**Ibën Battah** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“...dhe pas kësaj, ne nuk futemi në atë që ka ndodhur midis Sahabëve të të Dërguarit të Allahut – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, sepse kanë dëshmuar shumë ngjarje bashkë me të dhe ua kanë kaluar njerëzve me meritën e tyre; Allahu i ka falur ata dhe të ka urdhëruar ty që të kërkosh falje për ta si dhe të afrosh tek Ai me dashurinë për Sahabët, gjë të cilën Ai e ka bërë detyrë nëpërmjet gjuhës së Pejgamberit të Tij. Allahu e dinte se çfarë do të ndodhte midis tyre dhe se ata do ta luftojnë njëri-tjetrin, porse ata janë ngritur mbi të gjithë njerëzit e tjerë, sepse gabimi dhe gjynahu i tyre u është shlyer, dhe çdo gjë që ka ndodhur midis tyre u është falur.”<sup>16</sup>

**Imam Shafiu** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Kush i kundërvihet Sunnetit, do t’u kundërvihet Sahabëve; e kush u kundërvihet Sahabëve, do ta urrejë Pejgamberin – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –; dhe kush e urren Pejgamberin – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, ai e ka mohuar Allahun e Madhërishëm.”<sup>17</sup>

**Ibën Battah** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

---

<sup>14</sup> Sijeru ‘Alami en-Nubela, 10/92.

<sup>15</sup> Tarikh ibën Me’in, Riuajetu ed-Deurij (nr.2670), 3/546.

<sup>16</sup> El-Ibaneh fi Usuli es-Sunneh, fq. 268.

<sup>17</sup> Tabakatul-Hanabileh, 1/13.

“Për të gjithë muhaxhirët dhe ensarët dëshmohet që janë në Xhenet dhe që e kanë fituar kënaqësinë, faljen dhe mëshirën e Allahut.”<sup>18</sup>

---

---

<sup>18</sup> el-Ibanetu es-Sugra, fq. 319.



# Gjykimi i Ehli Sunetit për ata që shajnë dhe nënçmojnë Sahabët - radijAllahu 'anhum -

Më poshtë vijojnë sqarime të hollësishme nga dijetarët për disa gjykime ndaj atyre që shajnë Sahabët:

**1. Ai që i konsideron pabesimtarë të gjithë Sahabët – Allahu qoftë i kënaqur me të – ose shumicën e tyre, ose i konsideron njerëz të prishur të gjithë ata ose shumicën e tyre, ka bërë kufër.**

**Ibën Tejmijeh** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Kurse ai që kalon përtej kësaj, saqë pretendon se Sahabët e lanë fenë pas të Dërguarit të Allahut – sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem – përveç një numri të vogël që është dhjetë veta e ca, ose i konsideron të njerëz të prishur shumicën e tyre, atëherë nuk ka dyshim se ky ka bërë kufër, sepse ai e përgënjeshton atë që e ka thënë Kurani në më shumë se një vend dhe që i ka lavdëruar ata. Madje, edhe ai që dyshon në kufrin e këtij personi, i bëhet tekfir i veçantë me emër. Sepse kjo fjalë në vetvete tregon se mbartësit e Kuranit dhe Sunnetit janë qafira ose njerëz të prishur, dhe se ky ajët:

﴿كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ﴾

“Ju jeni njerëzit më të mirë që keni dalë për njerëzimin...”<sup>19</sup>

Më të mirët e tyre janë gjenerata e parë (Sahabët)...”<sup>20</sup>

**2. Ai që e konsideron të lejuar sharjen e Sahabëve, ka bërë kufër.**

**Ibën Tejmijeh** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“el-Kadij Ebu J’ala ka thënë: “Ai që e konsideron të lejuar sharjen e tyre, ka bërë kufër.”<sup>21</sup>

---

<sup>19</sup> Ali-Imran, 110.

<sup>20</sup> es-Sarimu el-Meslul, fq. 586-587.

<sup>21</sup> Mukhtesar es-Sarim el-Meslul, fq. 117

**3. Ai që i shan Sahabët për shkak të shoqërimit që ata kishin me Pejgamberin – sal-  
lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, ka bërë kufër.**

**Subkij** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Nuk ka dyshim se në qoftë se njeriu urren njërin nga këta të dy (domethënë Ebu Bekrin dhe Umerin – radijAllahu anhumā –) për shkak se e kanë shoqëruar Pejgamberin, ai është qafir. Madje edhe në qoftë se urren ata Sahabë që nuk janë në gradën e Ebu Bekrit dhe Umerit, për shkak se e kanë shoqëruar të Dërguarin e Allahut – *sal-lAllahu alejhi ue sellem* –, ai është qafir dhe kjo është një çështje e prerë.”<sup>22</sup>

**4. Ai që e shan ose bën tekfir mbi ndonjërin nga Sahabët – Allahu qoftë i kënaqur me ta – ose mbi ndonjë Sahab për të cilin kanë ardhur tekste që tregojnë për meritën e tij, siç janë katër Sahabët (Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu), ose shan gratë e Pejgamberit, ky që e bën këtë ka bërë kufër, sipas mendimit të saktë.**

**Ibën Tejmijeh** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Ahmedi në transmetimin e Ebu Talibit, në lidhje me personin që shante Uthmanin, ka thënë: “Kjo është zendekah (dalje nga feja).” Ndërsa sipas transmetimit të Meruedhit ka thënë: “Kush e shan Ebu Bekrin, Umerin dhe Aishen, unë nuk mendoj që ai është në Islam.”<sup>23</sup>

**El-Kadij ‘Ijad el-Malikij** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Ebu Zejdi transmeton nga Sahnuni se ai ka thënë: Kush thotë për Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin dhe Alijun se janë në devijim dhe kufër, ai njeri vritet. Ndërsa ai i cili i shan Sahabët e tjerë pos këtyre, ndëshkohet rëndë.”<sup>24</sup>

**Muhamed ibën Abdul-Uehhab** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Kush veçon ndonjë prej Sahabëve duke e sharë, e për atë Sahabij kanë ardhur një sërë transmetimesh për meritën dhe përkryerjen e tij, siç janë Khalifët e Drejtë për shembull, nëse ai beson që ai Sahabi meriton të shahet ose lejohet që të shahet, ai njeri ka bërë kufër,

---

<sup>22</sup> Fetaua Subkij, 2/575

<sup>23</sup> Es-Sarimu el-Meslul, 3/1065.

<sup>24</sup> Esh-Shifa, 2/1109.

sepse ai ka përgënjeshtuar transmetimin autentik nga i Dërguari i Allahut, lavdërimet dhe paqja e Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij, mbi Shokët e tij dhe mbi Gratë e tij.”<sup>25</sup>

**5. Ai që akuzon Aishen – radijAllahu anha – në nderin e saj, ose akuzon gratë e tjera të Pejgamberit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, ka bërë kufër.**

**Hafidh ibën Kethiri** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Të gjithë dijetarët kanë ixhma (unanimitet) se ai që shan Aishen pas zbritjes së këtij ajeti dhe e akuzon atë me akuzat e tij, pas kësaj që është përmendur në këtë ajet (ajeti 23 në Suren en-Nur), atëherë ai është qafir, sepse ai kundërshton Kuranin.”<sup>26</sup>

**Ibën Tejmijeh** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Në lidhje me sharjen e grave të Pejgamberit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, kush akuzon Aishen – Allahu qoftë i kënaqur me të – për atë gjë (për zina) që Allahu e ka pastruar atë, ka bërë kufër. Ixhman për këtë e ka transmetuar më shumë se një dijetar. Kurse ai që shan gratë e tjera të tij – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – për këtë ka dy medime:

Mendimi i parë: kjo është njësoj sikur sharja e Sahabëve të tjerë – e cila do të sqarohet në vijim.

Mendimi i dytë, e që është mendimi i saktë: ai që akuzon në nder njërën nga Nënat e Besimtarëve (gratë e Pejgamberit – alejhi salatu ue selam) është njësoj si ai që akuzon Aishen – radijAllahu ‘anha –.”<sup>27</sup>

**6. Për sa i përket atij që shan ndonjërin nga Sahabët për çështje të dunjasë, siç është: cilësimi i ndonjërit prej tyre si: koprrac, frikacak, i papërvojë në çështjet politike, i cekur në mendime dhe ide. Ky që e thotë këtë shpallet njeri i prishur (fasik) e nuk shpallet qafir, porse meriton të ndëshkohet.**

**Ibën Tejmijeh** – Allahu e mëshiroftë – thotë:

---

<sup>25</sup> Er-Raddu ‘ala er-Rafidah, 19

<sup>26</sup> Tefsir el-Kur` an el-Adhim, vëll. 6, fq. 31-32

<sup>27</sup> Mukhtesaru es-Sarimi el-Meslul, fq. 116.

“Por nëse ai i shan ata dhe nuk i cenon në besueshmërinë dhe fenë e tyre, si cilësimi i disave prej tyre se janë koprracë, frikacakë, të cektë në dituri, jo-asketë, ose gjëra të këtilla, ky meriton të qortohet dhe të ndëshkohet. Nuk gjykojmë me kufër për të vetëm për shkak se ai i ka përshkuar disa prej tyre me këto cilësi.”<sup>28</sup>

**Imam Ahmedi** – Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

“Nuk i lejohet askujt që t’i përmendë të këqijat e tyre, e as që të shajë ndonjërin prej tyre për shkak të një gabimi apo mangësie. Kush e bën këtë gjë, udhëheqësi e ka për detyrë që ta edukojë ose që ta dënojë, e nuk i lejohet udhëheqësit që ta falë, përkundrazi duhet ta dënojë dhe të kërkojë nga ai që të pendohet. Nëse ai pendohet, i pranohet pendimi, e nëse nuk pendohet, përsëri dënohet, rrihet dhe burgoset derisa të vdesë ose të kthehet nga ajo që ka thënë.”<sup>29</sup>

**Shejkh Salih Ali Shejkh** – Allahu e ruajttë – thotë:

Ata që shajnë Sahabët ndahen në disa lloje:

Lloji i parë: Nëse i shan të gjithë ata ose gjykon për shumicën e tyre se janë qafira dhe se e kanë lënë fenë përpos një numri të vogël, atëherë kjo është kufër, ngase ai e ka hedhur poshtë dëshminë e Allahut – të Madhëruar e të Lartësuar – ku thotë:

﴿لَقَدْ رَضِيَ اللَّهُ عَنِ الْمُؤْمِنِينَ إِذْ يُبَايِعُونَكَ تَحْتَ الشَّجَرَةِ فَعَلِمَ مَا فِي قُلُوبِهِمْ فَأَنْزَلَ السَّكِينَةَ

عَلَيْهِمْ وَأَثَبَهُمْ فَتْحًا قَرِيبًا﴾

“Allahu është i kënaqur me besimtarët kur ata bënë besëlidhjen me ty (o Muhamed) nën një dru dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre dhe Ai zbriti qetësi mbi ta dhe i shpërbleu me një fitore të afërme.”<sup>30</sup>

Është vërtetuar se ata që hynë në besëlidhje ishin 1400 persona, kurse në disa transmetime të tjera thuhet se ishin 1500 persona. (Buhariu 4153, Muslimi 1856).

<sup>28</sup> Es-Sarimu el-Meslul, 3/1110.

<sup>29</sup> “Tabakatul Habanile” i Ebu J’ala-së, fq. 30.

<sup>30</sup> El-Fet’h, 18.

Lloji i dytë: Sharja e disave prej tyre; dhe për këtë gjë ka sqarim të hollësishëm.

- 1) Nëse ai i shan ata për shkak të një interpretimi të gabuar që ka, si për shembull të besojë se ata kanë gabuar dhe se ata janë treguar të mangët dhe se atyre u ranë ato belatë, pra nga këndvështrimi i akides – siç besojnë kështu Khauarixhët – kjo është prej mëkateve të mëdha dhe nuk llogaritet prej gjërave që të nxjerrin nga feja.
- 2) E nëse i shan për shkak se është i mbushur me mllef dhe urrejtje kundrejt tyre, atëherë kjo është kufër dhe të nxjerr nga Islami. Dijetarët ka thënë: kjo është për shkak se Allahu – i Madhërishëm dhe i Lartësuar – kur i ka përshkruar Sahabët e të Dërguarit të Allahut, ka thënë:

لَيَغِيظَ بِهِمُ الْكُفَّارَ

“...(Allahu i ka bërë Sahabët me këto tipare) në mënyrë që përmes tyre t’ua shtojë mllefin pabesimtarëve ...”<sup>31</sup>

Kështu që, ai që ka mllef për Sahabët e Pejgamberit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – cilësohet me atë që e ka cilësuar Allahu i Lartësuar, se ai është prej qafirave (pabesimtarëve).”<sup>32</sup>

*Përktheu dhe përmblodhi: Jeton Shasivari*

*18 Shaban 1440 h.*

*23 Prill 2019*

*Gostivar*

---

<sup>31</sup> el-Fet’h, 29.

<sup>32</sup> Sherhu Lum’ati el-‘Itikad, fq. 145-146.